



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.07.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Shkodran Veseli Zyrtar i Zyrës së Prokurimit KRM” Ekoregjioni” SH.A Prizren
CC:	z. Hasan Hasani Kryesues i Bordit KRM” Ekoregjioni” SH.A Prizren
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin “Furnizimi me naftë për nevojat e Ekoregjionit – pesë (5) pjesë”



Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin “Furnizimi me naftë për nevojat e Ekoregjionit – pesë (5) pjesë” me numër prokurimit ER-12-004-111 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra e Prokurimit t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një (1) vite fiskal, secili Autoritet Kontraktues apo ndërmarrje publike duhet dorëzoj në Autoritetin Qendror të Prokurimit një planifikim përfundimtar me shkrim, në të cilat identifikohen në detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që Autoriteti Kontraktues parasheh të prokuroj gjatë vitit fiskal në fjalë, me çka sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit, Autoriteti Kontraktues ka dështuar se respektuari dispozitat e nenit 8 të LPP-së 04/L-042.

Zyra e prokurimit në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “ Ekoregjioni” SH.A , si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit “Furnizim ” të procedurës së hapur me nr. prokurimi ER-12-004-111 dhe titull tenderi “Furnizimi me naftë për nevojat e Ekoregjionit” në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit i Dosjes së tenderit te Kërkesat mundësit teknike dhe /ose profesionale, Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë : Vërejtje: Operatori Ekonomik që do të ofertojë duhet pa tjetër që të ketë pompë të karburanteve në (Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash dhe Rahovec). Pompa mund të jetë më së largu 3 km larg njësisë përkatëse, nga kjo rrjedh se departamenti i prokurimit ka bërë diskriminim territorial gjë që është në kundërshtim me nenin 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.

Me respekt!

